

mortore të Sofijes në vitin 2002. Familja i ka marr këto mbetje mortore vetëm më 22.02.2010 dhe i ka varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit Gllobar/Globare.

Burimet: deklarata B.U, FDH-32789; deklarata B.U, FDH-32806; deklarata A.LI, FDH-31877; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPE, *Remains...*, FDH-15297.

Ljubomir (Svetislav)

Ljubomirović

(21.04.1966, serb nga Lubostinjski Prnjavor, komuna e Tërstenikut, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Veljko (Predrag) Miljković

(16.07.1968, serb nga Krushevc, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Sreten (Velibor) Milić

(7.01.1970, serb nga Dedina, komuna e Krushevcit, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Ljubomiri ka qenë zëvendës komandanti i Shërbimit të Punëve të Brendshme në Tërstenik. Veljkoja ka punuar si nënoficer i Ushtrisë së Jugosllavisë deri në vitin 1991. Në janar të vitit 1993, ai u punësua në policinë e Krushevcit. Sreteni, po ashtu, punonte në polici në Krushevc. Që të tre ishin pjesëtarë të Njësiteve të Posaçme të Policisë [NJPP]. Gjatë vitit 1998, njësitë i tyre ka qëndruar në territorin e Suharekës/Suva Reka. Në datën **26.09.1998**, Ljubomiri, Veljkoja dhe Sreteni me njësitin e vet e ndërmoren bastisjen e shtëpive të fshatit **Tërdec/Trdevac**. Gjatë aksionit, ata që të tre u plagosën. Plaga e Sretenit ishte vdekjeprurëse dhe ai ndërroi jetë në vend. Pas pak, edhe Veljkoja po ashtu ndërroi jetë, ndërkaq Ljubomiri ka dhënë shpirt në rrugë për në spital. Ljubomirin e kanë varrosur në varrezat e Lubostinjski Prnjavorit më 27.09.1998. Veljkoja u varros në Varrezat e Vjetra të *Bezhanisë* në Beograd, ndërkaq Sreteni në varrezat e Dedines.

Burimet: deklarata V.Lj, FDH-25529; deklarata O.M, FDH-25335; MUP Srbije, Izveštaj o angazovanju 3. čete 37. Odreda PJP SUP Kruševac na Kosovu, 28.10.1999, FDH-16919; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 38, 42, 44; SMIP, *Teroristički...*, III, 513, 516, 520-524; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Idriz (Halil) Balaj

(8.08.1952, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, bujk, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Sylë (Ali) Balaj

(8.10.1961, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Milazim (Musli) Balaj

(4.05.1977, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, pjesëtar i UÇK-së)

Idrizi, Sylë dhe Milazimi kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Kur forcat serbe kanë hyrë në *Mëhallën Veselaj* në Gllarevë/Iglarevo [Klinë/Klina] më 23.09.1998, familjet e tyre, së bashku me banorë të fshatit, i kanë braktisur shtëpitë e veta. Ata që të tre kanë mbetur nëpër pyjet përreth fshatit. Kanë rënë gjatë përleshjeve me forcat serbe në grykën e **Vučakut/Vučak** më **26.09.1998**. U varrosën në varrezat e Tërdecit/Trdevac, vetëm kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati. Pas përfundimit të luftës, në datën 20.10.1999, mbetjet mortore të Idrizit, Milazimit dhe Sylës janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gllarevë/Iglarevo.

Burimet: deklarata E.B, FDH-33602; deklarata B.M, FDH-33603; deklarata R.B, FDH-33604; deklarata V.B, FDH-8879; KMDLNJ, *Bulletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 126, FDH-23857; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092.

Zymer (Adem) Hysenaj

(29.08.1941, shqiptar nga Obrija e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllogocit/Glogovac, murator, gjashtë fëmijë)

Zymeri me familjen jetonin në *Mëhallën Hysenaj* në Obri të Epërme/Gornje Obrinje. Ai dhe familjarët e tij, së bashku me banorë të tjerë të fshatit, i braktisën shtëpitë më 25.09.1998. Në një luginë, në afërsi të fshatit, ata i ngritën tendat. Përderisa hidhnin granata mbi fshatin më 27.03.1998, forcat serbe vërejtën se fshatarët gjendeshin jashtë shtëpive, në luginë afër fshatit. Pjesëtarë të forcave serbe lëvizën dhe i rrethuan civilët. Së pari, e ndan Zymerin dhe burra të tjerë nga gratë dhe fëmijët. Pasi i kontrolluan, i ndan dhe i kthyen pleqtë në turmën e grave